



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike

Mbledhja nr.27/2020

Prishtinë, më 10.12.2020, në orën 09:40

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Endrit Shala, kryetar, Mimoza Kusari – Lila, Hekuran Murati, Elbert Krasniqi, Ferat Shala dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Munguan: Doruntinë Maloku-Kastrati, nënkryetare e parë, Zoran Mojsiloviq, nënkryetar i dytë, Fidan Rekalju dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Arber Prenaj, OSBE; Dorentina Murturi dhe Blerina Muqolli, Kuvendi/media; Zhujë Binakaj, GPAAK; dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi, Endrit Shala, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i Propozim - Vendimit të Qeverisë, për zgjedhjen e bordit të ARKEP-it.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Shqyrtimi i Propozim - Vendimit të Qeverisë, për zgjedhjen e bordit të ARKEP-it

Kryetari theksoi se Qeveria ka proceduar “Propozim-vendimin për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të bordit të ARKEP-it” me të propozuarit si vijon: Bahri Anadolli, kryetar, Hazir Hajdari, Mark Buzhala, Iliriana Berisha dhe Faruk Rexhaj anëtarë. Materialin dhe CV-në e tyre i keni marrë. Edhe si komision i kemi kërkuar qeverisë që sa më shpejt të procedohen emrat sepse tani më ARKEP-i s’ka bord, sepse i ka përfunduar mandati me datë 5.12.2020. Në përputhje me ligjin për komunikime elektronike, ne, si komision, e kemi detyrë ta procedojmë për seancë plenare për miratim.

Mimoza Kusari-Lila theksoi se lista e sjell me kandidatë ka defekte sepse persona në këtë listë janë drejtpërdrejt të lidhur me subjektet politike në pushtet, duke mos dashur që mos me ia cenuar askujt të drejtën për profilizim politik, besoj që për një institucion të rëndësishëm kaq të madhe duhet të reflektojë Qeveria. Po ashtu, duhet të ketë në konsideratë Qeveria në plotësimin e kuotës gjinore sepse prej pesë kandidatëve vetëm një është grua edhe ajo është bashkëshortja e një ish- ministri të koalicionit qeverisës. Unë kërkoj që kjo listë të kthehet mbrapa që Qeveria me respektuar ligjin për barazi gjinore, në të cilin propozim të paktën është dashtë të jenë dy ose tri gra dhe të ketë më shumë inxhinierë të telekomunikacionit. Ne jemi kundër të votojmë këtë listë edhe në seancë do të kërkojmë që të kthehet në Qeveri kjo listë.

Pal Lekaj theksoi se sa i përket listës së kandidatëve të gjithë i përmbushin kushtet dhe nuk shoh asnjë konflikt interesi, sepse nuk janë në pozita ekzekutive, dhe nuk e di pse flitet këtu që është një grua e një ish- ministri, sepse nëse familjarët e tyre kanë qenë në pozita këtyre nuk duhet t'i mohohet e drejta me u punësuar. Sipas ligjit ne jemi këtu që ta procedojmë në seancë plenare dhe seanca të vendosë.

Kryetari theksoi se nëse pajtoheni kërkoj miratimin e propozimit që ta dërgojmë në parlament për shqyrtim, për arsye se ne nuk kemi mundësi as ta ndalojmë. Mirëpo, nëse nuk kemi pajtim atëherë propozoj që këtë çështje ta shtyjmë për mbledhjen e radhës kur edhe deputetja që ka kërkuar shtyrjen të jetë e pranishme bashkë me anëtarë tjerë të komisionit.

Hekuran Murati theksoi se tash kemi kuorum dhe mund të merret vendim. Për këtë listë sa po kuptoj nuk ka pasur konkurs, dhe për një institucion kaq të rëndësishëm, nuk duhet ta lejojmë një gjë e tillë të ndodhë ku emërohen persona pa kurrfarë konkursi, pa kurrfarë procedure. Ne si Komision t'i rekomandojmë seancës që kjo listë të mos votohet dhe t'i kthehet prapa Qeverisë. Kërkoj që të vendoset në votim propozimi i Qeverisë dhe të procedohet për Kuvend.

Kryetari theksoi se ne nuk mund t'i rekomandojmë as Kuvendit, as Qeverisë diçka që nuk është e përcaktuar me ligj. Unë edhe njëherë kërkoj nga të gjithë ju deputetë që këtë çështje ta lëmë ta diskutojmë të martën në mbledhjen e radhës si pikë të parë të rendit të ditës.

Ferat Shala u shpreh se t'i japim edhe një shanse të martën këtij propozimi. Unë jam që t'i japim deri të martën një afat, dhe pastaj ne të marrim qëndrim meritore në raport me rekomandimet për Kuvendin.

Pas debatit, në votim morën pjesë vetëm tre deputetë dhe votuan kundër.

Kryetari konstatoi se në bazë të Rregullores nuk ka kuorum për vendimmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:15.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetar i komisionit,

Endrit SHALA